



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:187472
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05874468

A.nr.2193/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Valbona Gjonbalaj, në konfliktin administrativ të paditësit A.S. nga fshati ..., Komuna e ... të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avoakt ... nga ..., kundër Ministrisë e Financave Punës dhe Transfereve- Inspektoratit i Punës (MPMS-IP), në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, në praninë e përfaqësuesit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, në seancën e datës 20.06.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit A.S. nga fshati ..., Komuna e ..., **si e bazuar.**
- II. ANULOHET si i kundërligjshme vendimi i të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektorati i Punës Nr.prot.526/22 i datës 29.07.2022.
- III. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Inspektorati i Punës (MFPT – IP) shpallet jo kompetent për vendosje sipas kërkesës/ankesës, ndërsa pala udhëzohet në kontest civil.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, u mbajt në pajtim me nenin 41 të LKA-së, në mungesë të palës së paditurë e ftuar me ftesë të rregullt nga gjyakta.

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij në gjykatë me datën 13.09.2022, ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektorati i Punës dhe ka kërkuar nga gjykata anulimin e vendimit të të paditurës MFPT – IP Nr.prot.526/22 i datës 29.07.2022. Përfaqësuesi i paditësit gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetemi ne tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se paditësi ne konkursin e brendshëm publik te ndërmarrjes ... i hapur me dt.07.05.2021 deri me dt.21.05.2021 për pozitën drejtues i trenave ka aplikuar paditësi i cili ka ndjekur te gjitha procedurat e aplikimit dhe rekrutimit dhe bazuar ne performancën e treguar ne testin me shkrim dhe intervistën me goje është përzgjedhur si kandidati i pare, është

nxjerr vendim për fillimin e tij ne pune dhe rrjedhimisht ka marre edhe ftese për fillimin e punës. Para se te fillonte procesi i rekrutimit, kryetari i komisionit kërkon opinion ligjor nga zyra ligjore e ..., nëse kandidatet që kane aplikuar i plotësojnë kriteret për aplikim me konkurs te brendshëm. Ne baze te malit te dt.02.06.2021 i cili është ne shkresat e lendes, opinioni i zyrës ligjore është pozitiv dhe ka vazhduar me tutje procesi. E gjithë problematika e konkursit te brendshëm publik rezulton te jete njëra nga anëtarët e komisionit konkretisht ..., e cila fillimisht në testin me shkrim e nënshkruan raportin e vlerësimit ku paditësi paraqet performance te shkëlqyer e me pas ne baze te shkresave te lendes ajo udhëzohet nga Kryeshefi, gjeja te nxerr një raport i cili shkon ne anulimin e konkursit, pavarësisht faktit se ishin kryer te gjitha procedurat e rekrutimit. Me dt.23.06.2021, anëtarja e Komisionit nxjerr një raport te porositur nga Kryeshefi me te cilin konstaton se gjeja paditësi nuk paska qenë i punësuar ne ndërmarrjen infrakos dhe nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit. Më tutje ka theksuar se Infrakos e konteston çështjen e punësimit me kontratën e cila ka qenë aktive ne kohen e konkursit dhe e cila e përmban numrin 742/2 te dt.15.10.2019, kontrate e cila ne përpikëri i përmban kriteret e përcaktuara me ligjin e punës, është kontrate me kohe te caktuar, janë te specifikuara shprehimisht punëdhënësi dhe punëmarrësi, kohëzgjatja e kontratës, paga dhe kushtet tjera. (Sa i përket burimeve te pagesës së pagës prej nga i merr Infrakos, është një çështje që nuk do te duhet te vendosej fare ne kontrate). Paditësi i shterr mjetet juridike brenda institucionit duke paraqitur kërkesë për fillimin e punës dhe nënshkrimin e kontratës, pastaj meqenëse merr një vendim te çuditshëm nga Infrakos, i drejtohet Inspektoratit te Punës i cili me vendimin numër 01 nr.08-389/2021 e aprovon ne tërësi si te bazuar ankesën e paditësit dhe paraqet gjendjen reale nga konkursi i brendshëm i hapur nga Infrakos. Pastaj, me vendimin e shkalles se dyte te Inspektoratit i cili është i atakuar me këtë padi aprovohet e bazuar ankesa e Infrakosit dhe prishet vendimi i shkalles se pare. Është thelbësore për gjykatën, të vërehet fakti se në arsyetimin e këtij vendimi përpiqen që të japin kahje tjetër kësaj çështje dhe për trajtim paraqesin një kontratë tjetër të punës numër 4/2 te dt.14.06.2021, që do te thotë se kjo kontrate fare nuk ka qenë aktive ne kohen e publikimit dhe kohëzgjatjen e konkursit te brendshëm. Kjo kontrate i referohet një periudhe te mëvonshme. Ne te njëjtën formë edhe ne përgjigje ne padi përpiqen që ta vendosin gjykatën ne lajthim duke i prezantuar kontratën e lartcekur, ndërsa ne kohen e publikimit dhe kohëzgjatjen e konkursit aktive ka qenë kontrata numër 742/2 e dt.15.10.2019. Janë vetëm dy elemente thelbësore për te vendosur ne këtë çështje administrative. Te konstatohet drejte nëse paditësi ka qene i punësuar tek e paditura dhe kjo dëshmohet me te gjitha faktet, dhe se dyti është fakti se interpretojnë dispozita nga një kontrate që fare nuk i referohet as datës se publikimit dhe kohëzgjatjes se konkursit. Prandaj kërkojmë që padia te aprovohet ne tërësi si e bazuar te anulohet vendimi numër IP 03-526/2022 I dt.29.07.2022 dhe te mbetet ne fuqi vendimi i shkalles se pare me numër 01 nr.08-389/2021A i dt.21.12.2021 ose çështja ti kthehet ne rivendosje te paditurës.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 16.01.2024, ka deklaruar se e kundërshtojnë në tërësi padinë e paditësi duke theksuar se organi i shkallës së parë gabimisht referohet në interpretimin e zyrës ligjore të Infrakos sepse Inspektoriati i Punës në rastin e realizimit të inspektimit është i pavarur dhe duhet të referohet vetëm në dispozita ligjore dhe nënligjore që rregullojnë procedurën e konkursit dhe asesi të bazhet në interpretimin e punëdhënësit apo përfaqësuesit të punëdhënësit dhe ka propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Vendimi me numër IP03-526/2022, i datës 09.07.2022.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, bëri administrimin e provave dhe atë: vendimi numër IP 526/22 I DT.29.07.2022; Vendimi numër 01 nr.08-389-2021 A, i dt.21.12.2021; konkursi intern nga Infracos i dt.07.05.2021; ankesa e paditësit numër 899 e dt.08.11.2021; kontrata e punës e paditësit e dt.07.06.2017 numër 4138; kontrata e punës e lidhur mes Infracos dhe paditësit numër 742/2 e dt.15.10.2019; Njoftimi i lëshuar nga Infracos i dt.18.06.2021; vendimi i lëshuar nga Infracos për pranimin e punëtorëve drejtues i trenave; emaili nga ... i dt.02.08.2021, i dt. 03.08.2021; raporti i lëshuar nga Infracos i dt.23.06.2021; emali i dt.28.06.2021 nga paditësi; kërkesa nga paditësi drejtuar Infracos i dt.28.10.2021; përgjigja ne kërkesë i lëshuar nga Infracos, vendimi numër 1038 i dt.23.11.2021; raporti zyrtar numër 08-389/21 nga IP; Kontrata për kryerjen e shërbimeve profesionale numër 507 e dt.02.06.2021; dërgimi i shkresave te lendes nga IP i dt.12.01.2022; rezultati i provimit i dt.04.06.2021; ankesa e dt.12.01.2022 nga Infracos sh.a.; vendimi numër .412 i dt.07.05.2021; kërkesa per trajnim e dt.07.06.2017; emaili zyrtar nga ... i dt.24.10.2017, vërejtja per raportin zyrtar te IP-së e dt.16.12.2021; pasqyra e llogarisë TRUST për periudhën 2017 deri me d5t.05.04.2022. Formulari ivleresimit te performances per periudhën 01.01.2021 deri 31.12.2021 e lëshuar nga Infracos sh.a.; Opinioni ligjor nga zyra ligjore Infracos i dt.02.06.2021 përmes emailit zyrtar nga

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, përgjigjes në padi ku ka gjetur se kërkesëpapia e paditësit është e bazuar.

Gjykata fillimisht shqyrtoi aktin administrativ të goditur me padi në përputhje me nenin 35 Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se:

“Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në bazë të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim, aktin administrativ edhe pa e dërguar padinë në përgjigjen”.

Nga vendimi i kundërshtuar, gjykata vlerëson se përmban të meta esenciale që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit. Kjo për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës, e paditura ka vendosur jashtë kompetencave të saj ligjore të përcaktuar me ligj.

Për të vlerësuar këtë, gjykata iu referua nenit 2 të Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, i cili përcakton se:

“2. Inspektorati i punës:

- a) Do të mbikëqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë.*
- b) Do t’iu siguroj informacion teknik dhe këshilla punëdhënësve dhe punëtorëve për çështjet më të efektshme të zbatimit të dispozitave ligjore.*
- c) Do të njoftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo ndonjë organ tjetër kompetent për ndonjë mungesë apo ndonjë shpërdorim në ligjin e aplikueshëm.*

- d) *Do t'iu siguroj informatat dhe këshillat punëdhënësve dhe punëmarrësve të cilat do të jenë në pajtim me ligjin dhe t'i paralajmërojnë autoritetet kompetente për çfarëdo defektesh apo shpërdorimesh që nuk janë përfshirë me dispozita ligjore ekzistuese.*
- e) *Do t'iu jep këshilla për çështje lidhur me ligjin e punës dhe mbrojtjen e punëtorëve me rastin e riorganizimit apo ristrukturimit të një ndërmarrjeje”.*

Ndërsa me Ligjin Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9, teksti te pika “a” e nenit 2, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë, zëvendësohet me tekstin “*Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë*”.

Në anën tjetër, neni 79 i Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, përcakton se:

Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

Sipas Ligjit për Gjykatat, kompetente për shqyrtimin e lëndëve nga marrëdhënia e punës sipas dispozitës së lartcekur, janë gjykatat themelore në kontest civil, varësisht nga kompetenca territoriale.

Në bazë të nenit 4 par.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, organet publike duhet të veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.

Paragrafi 2,3 dhe 4 i këtij neni përcakton se: “2. *Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj.*

3. *Nëse ligji autorizon organin publik të ushtrojë pushtet diskrecionar në një vendimmarrje (në vijim “diskrecioni”), ai do të ushtrohet në mënyrë të ligjshme vetëm nëse plotësohen këto kushte:*

3.1. *nuk tejkalon kufijtë e përcaktuar në ligjin që lejon diskrecionin;*

3.2. *zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin për të cilin ligji e parashikon diskrecionin dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Ligji, në veçanti me parimin e proporcionalitetit, dhe*

3.3. *zgjedhja e organit publik nuk është në kundërshtim me normat e gjithëpranuara të shkencës apo teknikës dhe nuk shkel parimet themelore të drejtësisë apo arsyes njerëzore.*

4. *Pushteti diskrecionar, përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, është mundësia që i jepet një organi publik, shprehimisht apo që nënkuptohet me ligj, për të vendosur duke zgjedhur në mes dy apo më shumë veprimeve të ligjshme, për t'i shërbyer në mënyrën sa më të përshtatshme interesit publik”.*

Bazuar në këtë, gjykata vlerëson se autoriteti i organeve administrative, në këtë rast i të paditurës Inspektorati i Punës, duhet të shtrihet deri në atë masë sa nuk tejkalon kufijtë e kompetencës të cilat me ligj të veçantë janë përcaktuar tek një institucion tjetër, në këtë rast, të gjykatës.

Lidhur më këtë, gjykata mori parasysh edhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese nr.ref.AGJ 2098/22 datë 16.12.2022, ku përcaktohet mes tjerash se:

“ajo çfarë i është lejuar Inspektoratit të Punës me nenin 83 të Ligjit të Punës dhe nenit 25 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin është mundësia e zbatimit të masës ndëshkuese (gjoba) në rast të konstatimit të parregullsive nga ana e punëdhënësit, si dhe raportimi i këtyre parregullsive në MPMS ose tek ndonjë autoritet tjetër kompetent. Asnjë normë e ligjit të Punës dhe Ligjit për Inspektoratin e Punës, nuk parasheh apo nënkupton që Inspektoratit të Punës t’i jepet autoritetet me atributet të një “gjykatë” apo të një “tribunali të pavarur”.

Gjykata konsideron se në rastin konkret pretendimi për ndërhyrje në kompetenca të gjyqësorit, nga ana e Inspektoratit të Punës, nuk rezulton të jete shkak i papajtueshmërisë së nenit 94 të Ligjit të Punës me Kushtetutën, gjegjësisht me nenet 3, 24, 31, 49 dhe 54 të Kushtetutës, por rezultat i interpretimit dhe i interpretimit dhe zbatimit të gabuar të nenit 94 të Ligjit të Punës dhe i Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës, nga ana e Inspektoratit të Punës. Sipas kuptimit të kësaj dispozite të Kushtetutës, gjykata referuese, por edhe gjykatat e instancave me të ulëta, gëzojnë juridiksion të plote, që në situatat kur ato ballafaqohen, qofte me kolizione të ligjeve, me interpretim a zbatim të gabuar ose arbitrarisht të ligjeve të aplikueshme, me tejkalim të kompetencave të përcaktuara me ligj nga ana e një autoriteti publik, apo me çfarëdo veprimi tjetër që bie ndesh me ligjin, t’i shpallin vendimet dhe veprimet e tyre të jashtëligjshme. Gjyqësorit i është besuar autoriteti i ushtrimit të një funksioni të rëndësishëm shoqëror, ai i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve e kontesteve të natyrës juridike, andaj i takon atij që përmes vendimmarrjes gjyqësore në përputhje me normat e zbatueshme, të përmbush këtë funksion shoqëror”.

Me nenin 43 par. 3 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, përcaktohet se:

“Nëse anulimi i aktit administrativ, sipas paragrafit 2. të këtij neni dhe zhvillimi i përsëritur i procedurës në organin administrativ kompetent do të shkaktoje për paditësin ndonjë dëm, i cili me vështirësi do të riparohej, apo nëse në bazë të dokumenteve zyrtare ose të provave të tjera në shkresat e lëndës është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative, apo nëse në të njëjtin konflikt administrativ është anuluar një herë akti administrativ, kurse organi administrativ kompetent nuk ka vepruar sipas aktgjyimit, gjykata mundet edhe vetë të vërtetojë gjendjen faktike ose me anë të organit tjetër dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin”.

Infracos Sh.a, sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare është person juridik e që stafi aty nuk është kategori e shërbyesve civil. Si rrjedhojë, procedurat e rekrutimit, rregullohen me Ligjin e Punës, edhe kontratat e punës në emër të paditësit i referohen Ligjit të Punës, për zgjidhjen e kontesteve në këtë kuptim, është kompetencë ekskluzive e gjykatave themelore në kontest civil.

Duke marr parasysh se lidhur me këtë çështjen e paditura ka vendosur jashtë autorizimeve – kompetencës që ka me ligj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi vet çështjen për atë që ka kompetencë dhe vendosi të anulojë vendimet dhe të paditurin e shpallë jo kompetente për vendosje në këtë çështje.

Prandaj marr parasysh fushëveprimin dhe funksionin e Inspektoratit të Punës, të përcaktuar me Ligjin nr.2002/9, del se e paditura ka nxjerr vendim të pabazuar në këtë ligj, e që në këtë rast ka të bëjë më të vendosurit lidhur me çështjen e mardhënies së punës së paditësit nga ana e punëdhënësit, në këtë rast kompanisë “Infrakos Sh.a”.

Kështu neni 52 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcakton se:

“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

1.1 është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji;

1.2 organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë;”.

Kështu MPMS-IP, duke vendosur lidhur me çështjen e ankesës së ushtruar nga ankuesi, kishte vepruar pa pasur kompetencë dhe në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, prandaj gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi duke anuluar si të paligjshëm vendimin e më pas duke shpallë jo kompetent këtë organ dhe palën ta udhëzojë në kontest civil.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, u morë duke u bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, në kuptim të nenit 5,6, 35 dhe 38 si dhe Nenit 46.3 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.2193/22, dt.20.06.2024

G j y q t a r e
Valbona Gjonbalaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.